

Deklarata e fëmijëve për sigurinë në rrugë

Pse mijëra fëmijë vriten dhe lëndohen çdo ditë në rrugë në gjithë botën?

Sepse për sigurinë në rrugë nuk është bërë mjaft! Ju udhëheqësit tanë duhet të dëgjoni dhe të veproni.

Ne jemi fëmijë. Në të ardhmen mund të kemi ndonjë rol, por tash për tash, jeni ju që duhet të na ndihmoni. Veprime konkrete për sigurinë në rrugë duhet të merren sa më parë që të jetë e mundur ose shumë fëmijë nuk do ta gëzojnë mundësinë që të rriten dhe të dëgjohet zëri i tyre.

Dhe për këtë mund të ndihmoni ju udhëheqësit tanë dhe të rriturit duke iu bashkuar kësaj thirrjeje për veprim sa më të shpejtë dhe për të siguruar që të gjithë fëmijët të udhëtojnë të sigurt.

Ne të gjithë meritojmë udhëtim të sigurt nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas. Rrugët duhet të bëhen të sigurta për të lëvizur shpesh. Ne fëmijët dëshirojmë trotuare të sigurta dhe korsi të sigurta për biçikleta. Duam të vihen pengesa statike në rrugë, për të ngadalësuar lëvizjen e makinave. Ne duam kushte të sigurta, në mënyrë që të edukohemi pa frikë dhe pa lëndime.

Ne bëjmë thirrje që të gjitha makinat që bartin fëmijë, kudo në botë, të jenë të sigurta. Të gjitha makinat dhe autobusët duhet të posedojnë rripa të sigurisë. Kur udhëtojnë me të rritur në motoçikleta, kërkojmë që fëmijët të kenë helmata për mbrojtje.

Ne e dimë që bartja e helmetës dhe vënia e rripit të sigurisë mund të shpëtojnë jetë.

Konsumimi i alkoolit nga shoferët përbën një rrezik të madh. Shpejtësia e madhe është e rrezikshme. Shoferët nuk lejohen të konsumojnë alkool dhe as të zhvillojnë shpejtësi të madhe. Askush nuk duhet ta bëjë këtë. Policia duhet të bëjë më shumë për të na mbrojtur dhe për të ndaluar njerëzit që ngasin automjete shpejt dhe të dehur. Ne duhet të jemi të mbrojtur gjatë gjithë kohës – kur jemi jashtë me familje, kur luajmë ose kur shkojmë në shkollë dhe kthehemi prej shkollës.

Duhet të bëhen ligje. Zërat duhet të dëgjohen dhe duhet të veprohet për të mundësuar sigurinë në rrugë për të gjithë fëmijët në mbarë botën.

Prandaj ne fëmijët ju bëjmë thirrje juve, udhëheqësve të botës, që në synimet e reja për zhvillimin global, të përfshini veprimet kundër vdekjes në rrugë. Kudo që jetojmë, ne duam dhe presim siguri në rrugë për shokët tanë, për familjen dhe veten tonë.

Ne jemi vetëm fëmijë dhe zëri ynë nuk është dëgjuar gjithmonë. Pra, duhet të na ndihmoni duke vepruar.

Nëse na mundësoni rrugë të sigurta tash, ne do të mund të jemi shembull për gjeneratat e ardhshme.

#SaveKidsLives
with road safety